



Pyetje dhe Përgjigje

Skema e Granteve të Vogla

Referenca Nr. GLPS-01/2026 | Financuar nga Bashkimi Evropian

Ky dokument përmbledh pyetjet e pranuar nga aplikuesit potencial gjatë sesionit informues dhe pyetjet e dërguara me shkrim, së bashku me përgjigjet zyrtare të ofruara nga GLPS. Të gjitha pyetjet janë anonimizuar dhe redaktuar për qartësi. Këto përgjigje nuk e ndryshojnë Thirrjen për Aplikime - dokumenti zyrtar i thirrjes mbetet referenca kryesore.

P01 Pranueshmëria - Periudha Minimale e Regjistrimit

PYETJA

Organizata jonë është një OJQ e regjistruar në Kosovë, e regjistruar zyrtarisht më 30 korrik 2025. Udhëzimet përcaktojnë se organizatat aplikuese duhet të jenë të regjistruara së paku një vit para publikimit të thirrjes. A mund të sqaroni nëse organizatat e regjistruara për më pak se një vit mund të aplikojnë, qoftë në mënyrë të pavarur apo në partneritet me një organizatë tjetër të pranueshme?

PËRGJIGJIA

Sipas kriterëve të përcaktuara në këtë thirrje, organizatat aplikuese duhet të jenë të regjistruara së paku një vit para datës së publikimit të saj. Ky kriter zbatohet njësoj edhe për organizatat që aplikojnë në partneritet.

Rrjedhimisht, organizatat e regjistruara për më pak se një vit nuk janë të pranueshme për të aplikuar në kuadër të kësaj thirrjeje.

P02 Dokumentacioni i Kërkuar - Certifikata e Administratës Tatimore

PYETJA

Dëshirojmë të sqarojmë se çfarë nënkuptohet me “Certifikatën Verifikuese të Administratës Tatimore”, e cila figuron në listën e dokumenteve të kërkuara. A i referohet kjo certifikatës që dëshmon se organizata nuk ka obligime të papaguara ndaj Administratës Tatimore, certifikatës së numrit fiskal apo ndonjë dokumenti tjetër?

PËRGJIGJIA

“Certifikata Verifikuese e Administratës Tatimore” i referohet Vërtetimit Tatimor, e cila vërteton se organizata nuk ka detyrime të papaguara ndaj Administratës Tatimore të Kosovës (ATK). Ky dokument mund të shkarkohet në format PDF përmes llogarisë së organizatës në platformën elektronike të deklarimit të ATK-së në www.edeklarimi.atk-ks.org.

Sa i përket Certifikatës së Numrit Fiskal dhe Certifikatës së Regjistrimit, organizatat e regjistruara së fundmi e kanë numrin fiskal të integruar në Certifikatën e Regjistrimit të OJQ-së, të lëshuar nga Departamenti për OJQ në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Nëse certifikata e regjistrimit e përmban numrin fiskal, mjafton të dorëzohet ai dokument. Në rastet kur këto dokumente janë të ndara, duhet të dorëzohen të dyja.

P03 Dokumentacioni i Kërkuar - Referenca nga Projekte të Mëparshme

PYETJA

Lidhur me referencën e kërkuar nga projektet e mëparshme, a duhet të dorëzohet një letër formale reference apo mjafton të ofrohet një person kontaktues nga organizata apo donatori me të cilin është zbatuar një projekt i ngjashëm?

PËRGJIGJIA

Të dy formatet janë të pranueshme. Referenca mund të dorëzohet në formën e një letre reference ose përmes listimit të projekteve relevante të zbatuara më parë, duke përfshirë të dhënat e plota të kontaktit të donatorëve për secilin projekt. Kjo formë pranohet me kusht që informacioni i ofruar të jetë i saktë, pasi komisioni vlerësues mund të verifikojë dhe konfirmojë përvojën e organizatës gjatë procesit të vlerësimit.

P04 Pranueshmëria - Iniciativat Individuale dhe të Peregjistruara

PYETJA

A kanë të drejtë të aplikojnë individët ose iniciativat joformale që nuk janë të regjistruara si OJQ? A ekzistojnë mundësi bashkëpunimi ose partneriteti për iniciativa që janë ende në fazën e zhvillimit? Gjithashtu, a mund të konsiderohet e përshtatshme për këtë thirrje një iniciativë e fokusuar në ndërgjegjësimit, fuqizim emocional dhe zhvillim personal të të rinjve?

PËRGJIGJIA

Në kuadër të kësaj Thirrjeje për Aplikime, vetëm OJQ-të e regjistruara që plotësojnë të gjitha kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në thirrje mund të aplikojnë si aplikues kryesor. Për këtë arsye, individët dhe iniciativat e peregjistruara nuk janë të pranueshme për aplikim. Megjithatë, iniciativat që ndodhen ende në fazën e zhvillimit mund të shqyrtojnë mundësitë e bashkëpunimit ose partneritetit me organizata të regjistruara që kanë objektivat dhe interesat të ngjashme tematike. I inkurajojmë të gjitha palët e interesuara të ndjekin mundësitë dhe thirrjet e ardhshme të publikuara nga GLPS.

P05 Pranueshmëria - Organizatat me Përvojë të Gjatë

PYETJA

Nëse organizata jonë është e regjistruar dhe aktive prej më shumë se 20 vitesh, a kemi të drejtë të aplikojmë në kuadër të kësaj thirrjeje?

PËRGJIGJIA

Po. Të gjitha organizatat jofitimprurëse të regjistruara në Kosovë, të cilat plotësojnë kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në këtë thirrje, kanë të drejtë të aplikojnë. Nuk ka kufizim maksimal lidhur me kohëzgjatjen e regjistrimit apo historikun e veprimtarisë së organizatës. Për rrjedhojë, organizatat me përvojë të gjatë janë të mirëseardhura të aplikojnë.

P06 Dizajnimi i Projektit - Shtrirja Gjeografike

PYETJA

A ekziston ndonjë kufizim lidhur me numrin e komunave që mund të përfshihen në një projekt? A mund të realizohen aktivitete në më shumë se një komunë në kuadër të të njëjtit projekt?

PËRGJIGJIA

Nuk ka kufizime lidhur me numrin e komunave që mund të mbulojë një projekt. Një projekt mund të përfshijë aktivitete në një ose më shumë komuna.

Me rëndësi është që aktivitetet e propozuara të jenë të lidhura qartë me objektivat e projektit, ndërsa buxheti i paraparë të jetë realist dhe proporcional me fushëveprimin e aktiviteteve të planifikuara.

Për pyetje të mëtejshme, ju lutemi kontaktoni:

applications@legalpoliticalstudies.org

Afati për pyetje me shkrim: 4 qershor 2026 | Submission deadline: 14 qershor 2026, ora 23:59

Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura janë vetëm të GLPS-së dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bashkimit Evropian.